# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-478706**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Me mua iku edhe OFL”, Lleshaj: Gjermania e ka miratuar sot një kopje të atij ligji. Krimit i duhet hequr paraja |
| ADRESA | `https://a2news.com/shqiperia/politike/me-mua-iku-edhe-ofl-lleshaj-gjermania-e-ka-miratuar-sot-nje-k-i1186066` |
| BURIMI | a2news.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 10:21:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 09:38:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2f67083fc8cf81f8c81b99f89014f256206cda251407f1ea77bc4b87722387df` |
| TEKSTI | `a985746f1dd80b74aee7eafb8a9aba64746dc4b6acfb27621f703f2573189d71` |
| PAMJA | `e490f3d4ee7e6f76b4163c7d076f733012b47b63f5d50fe88b55f800d9b22763` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b28c2f2a6b9aeaa2144e5474c05220d33f134e3e0a2416a507605eaca7e7e3a0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f52a1d397c683d722882998d1b0c047f87c1de2f74016889fd5b4e655403fa0f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b28c2f2a6b9aeaa2144e5474c05220d33f134e3e0a2416a507605eaca7e7e3a0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Me mua iku edhe OFL”, Lleshaj: Gjermania e ka miratuar sot një kopje të atij ligji. Krimit i duhet hequr paraja

Nga A2 CNN
29 Shtator 2026, 11:38 | Politikë




Ish-ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, deklaroi se Shqipëria e ka të humbur luftën me krimin e organizuar dhe korrupsionin nëse nuk rikthehet Operacioni Forca e Ligjit.

“Miratoi Gjermania një ligj për drejtësinë financiare, i cili është kopje e një ligji që bëmë ne dikur, OFL. Patëm nisur, asokohe, një tentativë ku thamë: krimi është biznes i egër. Krimi në Shqipëri, krimi i organizuar, bëhet për lekë, nuk bëhet për gjë tjetër. Askush nuk ka dalë të vrasë njerëz kot rrugëve. Çfarë duhet bërë? I duhet hequr paraja. Po i hoqe paratë, eliminove krimin”, tha Lleshaj në “Off the Record” nga Andrea Dangllli në A2 CNN.

“Dhe atëherë patëm thënë që ne e kemi të vështirë që ta mbajmë barrën e provës vetë dhe të provojmë që ora është shumë e shtrenjtë. Apo makina, apo shtëpia, apo kontrata bankare, apo kriptovaluta apo të tjera. Dhe thamë: ne s'e provojmë dot, provoje ti. Pra, barrën e provës do ta kalojmë tek ti që e ke edhe pasurinë mbi supe. Hajde, provoje që është e jotja. Nëse e provon, e gëzofsh. Nëse s'e provon, do të sekuestrohet dhe të konfiskohet. Ndodhi që filluam me një vrull të madh, por ndodhi që unë, dikur, pas pak kohe, dhashë dorëheqjen për arsyet e mia që dihen dhe, çuditërisht, pa kaluar as dy javë, iku edhe ligji. Bashkë me mua iku ligji”.

Sipas Lleshajt, anulimi i ligjit ishte i qëllimshëm. “Përgjigjja këtu është e qartë. U anulua ligji që kishim miratuar me luftë të madhe për t'u anuluar. Atëherë na thanë që ky ligj nuk është shumë korrekt e demokratik, ndërkohë që qeveria gjermane e ka miratuar këtë ligj dhe më pas do të kalojë në parlament, që thotë: çdo pronë, sigurisht, mbi një limit të caktuar, duhet provuar. Dhe këtë do ta bëjë dogana, jo prokuroria, as gjykata. Ke 30 ditë kohë ta provosh, përndryshe ndahu me të”, shtoi Lleshaj. “Shqipëria, pa bërë këtë, duhet t'i harrojë këto teatro. Thjesht duhet t'i harrojë”.

Sipas tij, nga viti 2020 kur nisi zbatimi i Operacionit Forca e Ligjit, Shqipëria nuk ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. “2020 ishte vendimtar edhe për luftën kundër krimit, edhe për mua personalisht. Në 2020-n filloi aplikimi pikërisht i këtij ligji që filluam dhe goditjen. U shkoi një formular shumë mijëra vetëve në Shqipëri. U shkoi një formular që u kërkohej justifikimi për pasuritë që ishin evidentuar, dhe jo për orë të shtrenjta, por edhe për makina, por për pasuri gjigante. Filluan shumë njerëz të kërkonin dokumentet për t'i justifikuar. Dhe pastaj i ranë më shkurt, anuluan ligjin”, tha Lleshaj.

“Nuk kemi bërë progres esencial në luftën kundër aseteve kriminale, për arsye se është shumë e vështirë, përmes prokurorisë, me ato kapacitete që ka, në rrugë penale. Është e

TE FUNDIT

Liga e Kombeve, Italia pa mëshirë, i jep leksion Turqisë me katër gola

Të shtëna me armë gjatë operacionit antikanabis në Qafështamë, dyshohet për policë të përfshirë

60 mijë vende, Roma shumë shpejt me një stadium të ri, miratohet projekti

80 vjet nga Masakra në Nikaj-Mërtur, Çelaj: U pushkatuan pa gjyq thjesht pse refuzuan të ulnin kryet para diktatit komunist

MË TË VIZITUARAT

Vëmendja te sfida në Sevilja, Spanja dhe Kroacia gati për të dhuruar spektak...

Formacioni i mundshëm, ndryshime në kampin kuqezi, Maran ka gati titullarët e...

Amerikanët ikin përfundimisht nga Iraku, ekspertët: Fitore për Iranin dhe ale...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

vështirë, për të mos thënë në Shqipëri e quaj të pamundur, që prokuroria të mund ta bëjë këtë. Prokuroria merret me krimin aktual. Ndërsa kjo pjesa, le të themi, e fshehtë, që nuk vret, e krimit që nuk vret, krimi që thjesht është një pasuri aty që shtohet e shtohet e shtohet, kjo, në rrugë penale, është shumë e vështirë të adresohet". **(A2 Televizion)**

## A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

Ndalesa e parë Tirana, Ursula von der Leyen nis të mërkurën turin ballkanik

Zgjedhja e Endrit Shabanit dhe dënimi i Ervin Salianjit, sot në Gjykatën Kushtetuese

Parti e re opozitare? Ermal Hasimja paralajmëron projektin me 25 intelektualë

"Si do ta rrëzoni Ramën?", Noka debat me Hasimen: Ky është regjim, duhet kryengritje

Përjashtohet Kosova, plani i BE-së për mbylljen e bisedimeve me Shqipërinë

"Dëshiron të hysh në BE si narkoshtet?", Noka debat me Nazarkon: Unë dua të futem në Europë

## Latest Videos









60 mijë vende, Roma shumë shpejt me një stadium të ri, miratohet projekti




Ursula vjen në Ballkan. Prezanton formulën e re të zgjerimit? Pse Kosova mbeti jashtë




Vëmendja te sfida në Sevilja, Spanja dhe Kroacia gati për të dhuruar spektakël




Formacioni i mundshëm, ndryshime në kampin kuqezi, Maran ka gati titullarët e tij



© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.